



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 92, Datë 04.07.2017

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2017 PËR KESH sha.

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, pika “e”, nenit 109, pika 5; nenit 110, pika 2 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; gjithashtu dhe nenit 14 dhe neni 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; neneve 8; 11; 12; 13 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2017 për shoqërinë “KESH”sh.a., të përgatitur nga Grupi i Punës;

Konstatoi se ;

- Me anë të shkresave Nr 773 Prot, datë 03.11.2016 dhe Nr.276 Prot. datë 30.03.2017 në zbatim të nenit 10 te VKM-së Nr.244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit,transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” është kërkuar nga ERE, paraqitja për miratim e Planit të Investimeve të shoqërisë KESH sha, për vitin 2017 sipas kërkesave të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- Grupi i punës, i ngritur me urdhër të Kryetarit të ERE-s Nr. 25, datë 11.05.2017, duke mbajtur në konsideratë shkresën nr 635/5 datë date 27.02,2017 të shoqërisë KESH sh.a. me të cilën është dërguar në ERE plani i investimeve të KESH sh.a. së bashku me shkresën nr. 578/1 Prot, datë 02.02.2017 të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me të cilën kjo e fundit është shprehur për “Miratimin e Programit Ekonomiko-Financiar të KESH sha, për vitet 2017-2021”, mori në shqyrtim tabelën e “Planit të Investimeve për shoqërinë KESH sh.a.për , vitin 2017”.
- Gjatë shqyrtimit të këtij informacioni, grupi i punës konstatoi se ky informacion plotësonte një pjesë të kërkesave të përcaktuara në “Rregulloren për Procedurat e

Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Licenuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e ERE-s, Nr.62, datë 15.09.2009

1. Edhe pas kërkesave të përsëritura nga ana e ERE-s, është konstatuar paraqitje jo e plotë e dokumentacionit, sipas kërkesave të përcaktuara në Neni 11 Pika 2 të *“Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Licenuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike”*
2. Vërehen mangësi dhe në :
 - a) Raport lidhur me zbatimin e planit të vitit paraardhës (Neni 7 pika 3)
 - b) Relacion shpjegues për investimet e planifikuara (Neni 7 Pika 1)
 - c) Paraqitje e kërkesave të Neni 8 (Plani I investimeve për të licensuarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike)
2. Investimet janë paraqitur kryesisht me nocion buxhetimi e pak teknik.
3. Koha e paraqitjes e pa mjaftueshme për një analizim teknik
4. Nevoja për saktësim të planit pas vendimit lidhur me tarifat 2017.
5. Nevoja për saktësimin e dokumentacionit sipas procedurave.
6. Nevoja për miratimin e një plani Investimesh Fisibel

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e *“Planit të Investimeve për kompaninë “KESH”sha, për vitin 2017”*.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI